



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministria e Brendshme Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Ministria e Shëndetësisë

Nr. 4024 Prot, Nr. 385/2 Prot, Nr. 1613 Prot, Nr. 4029 Prot,
datë 02.8.2013 datë 02.09.2013 datë 04.09.2013 datë 10.9.2013

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS,
MINISTRISË SË BRENDSHME,
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE
TË BARABARTA

“PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN NË SHKOLLË TË TË GJITHË
FËMIJËVE TË MOSHËS SË DETYRIMIT SHKOLLOR”

Mbështetur në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që më poshtë do të quhen “palë”, lidhin këtë Marrëveshje për bashkërendimin e punës për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

I. Objekti i marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshjeje është:

1. Përfshirja e të gjitha institucioneve për ndjekjen e arsimit bazë nga të gjithë fëmijët e moshës së detyrimit shkollor.
2. Koordinimi i Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR)/Zyrave Arsimore (ZA) dhe shkollave me njësitë bazë të qeverisjes vendore, Zyrrat e Gjendjes Civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Qendrat Shëndetësore për regjistrimin e fëmijëve në arsimin e detyruar.

II. Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor.

III. Detyrime të përbashkëta

1. Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet punonjësve të ngarkuar me këtë përgjegjësi.
2. Palët organizojnë takime të përbashkëta, çdo gjashtë muaj, për të analizuar problematikat e konstatuara dhe për të gjetur zgjidhjet për to.
3. Palët i dërgojnë njera-tjetrës informacione në formë shkresore dhe/ose elektronike për problemet që lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes.

IV. Detyrimet e palëve

IV.1 Detyrimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ngarkon DAR/ZA-të dhe shkollat arsimi bazë me këto detyra:

1. DAR-i, për territorin ku nuk përfshihen ZA-të e veta dhe ZA-të, hartojnë një listë të vetme emërore të fëmijëve, që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhëm shkollor, duke ballafaquar të dy listat e ardhura nga zyra përkatëse e gjendjes civile dhe qendra përkatëse shëndetësore.
2. DAR dhe ZA u dërgon listën e parashikuar në pikën 1 të gjitha shkollave në juridiksion (publike dhe ato private) brenda muajit maj.
3. Në fund të periudhës së regjistrimit në shkollat publike, drejtorët e shkollave të arsimit bazë, publike dhe ato private u dërgojnë DAR/ZA-ve përkatëse listat emërore të fëmijëve të regjistruar në shkollat e tyre.

